



ANTIBIOTIKËT NË BLEGTORI



MIKRO-ORGANIZMAT

Mikro-organizmat janë kudo. Ato përfshijnë bakterie që disa herë shkaktojnë sëmundje dhe infeksione te njerëzit, zogjtë, kafshët, bletët dhe bimët.




A mundet që mikro-organizmat të prekin më shumë se një specie?

PO. Disa mikro-organizma mund të prekin më shumë se një specie dhe shumë prej tyre mund të infektojnë kafshët, zogjtë dhe njerëzit. Disa mikro-organizma që gjenden në kafshë dhe zogj të shëndetshëm mund të shkaktojnë sëmundje te njerëzit. Mikro-organizmat përhapen në shumë rrugë, përfshirë edhe nëpërmjet ushqimit ose mjedisit.



ANTIMIKROBIKËT

Antimikrobikët që vrasin bakteriet quhen Antibiotikë. Këto medikamente na ndihmojnë të trajtojmë sëmundjet e shkaktuara nga bakteriet në njerëz, kafshë, shpendë, peshk, bimë dhe kafshët e shoqërimet.



REZISTENCA ANTIMIKROBIALE

Bakteriet me rezistencë antimikrobiale mund ti mbijetojnë trajtimit me antibiotikë të cilët më parë e ndalonin rritjen e këtyre bakterieve. Ky problem përkeqësohet nga mbipërdorimi ose keqpërdorimi i antibiotikëve.



MBETJET E ANTIOTIKËVE

Pasi kemi trajtuar kafshët me antibiotikë, duhet kohë që ato të zbërthehen dhe eliminohen nga trupi i kafshës. Gjurmë të antibiotikëve të gjetura në mish, qumësht, peshk, mjalt, ose vezë quhen **Mbetje Antibiotiku**.

RZISTENCA ANTIMIKROBIALE MUND TË...


Përhapet nëpërmjet mishit, qumështit, peshkut, vezëve dhe mjedisit

E bën të pa-efektshëm përdorimin e antibiotikëve për trajtimin e sëmundjeve në njerëz, zogj dhe kafshë.

MBETJET ANTIOTIKE MUND TË...

Shkaktojnë probleme shëndetësore te njerëzit që konsumojnë ushqim të kontaminuar

Rezultojnë në produktet ushqimore të eksportit që janë refuzuar nga vendet e tjera



ANTIBIOTIKËT NË BLEGTORI

CILA ËSHTË ZGJIDHJA

për të ruajtur kafshët dhe njerëzit të shëndetshëm dhe të sigurojmë efektin e antibiotikëve



ULNI PËRDORIMIN E ANTIBIOTIKËVE

- Përmirësoni biosigurinë për ta mbajtur sëmundjen larg fermës tuaj
- Zbatoni praktikat e mira në fermë për të minimizuar sëmundjet
- Përdorni vaksinimin sa herë është e mundur
- Vëzhgoni kafshët me kujdes për të zbuluar sëmundjet herët
- Mos përdorni antibiotikët për stimulimin e rritjes/peshës ose për parandalimin e sëmundjes para se ajo të shfaqet
- Përdorni antibiotikët vetëm kur vërtet është e nevojshme

PËRDORNI ANTIBIOTIKËT ME ZGJUARSIS

- Këshillohuni me veterinerin për trajtimin e sëmundjeve
- Dërgoni kampione në laborator që të percaktoni antibiotikun e duhur që duhet të përdorni
- Zbatoni instruksionet për sasinë dhe kohë-zgjatjen e përdorimit të antibiotikëve, edhe kur kafshët janë përmirësuar
- Për të evituar mbetjet e antibiotikëve, respektoni numurin e ditëve pas trajtimit me antibiotik para përdorimit të mjaltit, qumështit, vezëve, ose para therjes së kafshëve për mish
- Mos përdorni antibiotikë jashtë dates së skadencës, respektoni rregullat e eliminimit të trye